



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE  
SEKTORI JURIDIK**

Nr. 1359/prot.

Tiranë, më 03.12.2018

**URDHËR**

Nr. 51, datë 03.12.2018

**PËR  
“NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR PRANIMIN E APLIKIMEVE TË  
STUDENTËVE, TË CILËT PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E  
SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019, NË UNIVERSITETIN E  
ARTEVE”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar) dhe në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Arsimit nr. 27, datë 29.12.2017 për “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë,

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e grupit të punës për pranimin e aplikimeve të studentëve, të cilët përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2018-2019, në Universitetin e Arteve (UART), me përbërje si më poshtë:
  - Elia PLAKU
  - Jeta SHASHAJ
  - Ted KAMBERI
2. Grupi i punës ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar), (formulari bashkëngjitur), publikuar Web-in e UART.
3. Studentët duhet të dorëzojnë aplikimet/formularin, pranë zyrës së Protokollit në Rektorat.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



4. Afati i dorëzimit të aplikimeve nga ana e studentëve është deri në datën 21 Dhjetor 2018.
5. Zyra e Protokollit i regjistron aplikimet e studentëve në një regjistër të veçantë.
6. Grupi i punës pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga studentët, i përgatit i përgatit informacionin Administratores së Universitetit të Arteve (UART), për miratim në Bordin e Administrimit.
7. Në çdo rast, kur një student aplikant paraqet dokumentacion/formularin, për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2018 - 2019, që në të ardhmen rezultojnë jo ligjorë, përgjegjësia bije mbi studentin i cili do të penalizohet.
8. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Web-it, të Universitetit të Arteve.
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, zyra e Protokollit në UART, anëtarët e grupit të punës dhe sekretaritetë e Fakulteteve për njoftimin dhe shpalljen e këtij urdhri.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë**



**Prof. Kastriot Çausi**